

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Ekonomike,me gjyqtarin Asllan Krasniqi duke vendosur lidhur me çështjen juridike të paditësit D.sh.p.k me seli në K.,ndaj të të paditurës K. E. sh.p.k me seli në P.,në praninë e të të autorizuarëve të palëve ndërgjyqëse (të të autorizuarit me shkrim avokatit D. R. nga K. i cili e përfaqësoj palën paditëse dhe të të autorizuarit me shkrim të palës së paditur avokatit L. B. nga P.),lidhur me pagesën e borxhit në shumë të përgjithshme prej;11.888,20 euro,në seancën e shqyrtimit kryesor të datës;12.05.2015,ndërsa pas marrjes së fjalës përfundimtare të hartuar nga palët ndërgjyqëse,me datën;27.05.2015 merr këtë:

#### A K T V E N D I M

Shfuqizohet aktvendimi për lejimin e përmbarimit E.nr.145/2013 i datës;22.03.2013 pas kundërshtimit të palës debitore të ushtruar ndaj propozimit për përmbarim të palës kreditore,ndërsa pas vazhdimit të kontestit të rregullt civil gjykata merr këtë;

#### A K T G J Y K I M

Aprovohet pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit D. sh.p.k me seli në K..

I.Detyrohet pala e paditur që ti paguaj palës paditëse shumën e përgjithshme prej;11.662,00 euro (njëmbëdhjetëmijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e dy euro),në emër të borxhit kryesor për shkak të kryerjes së analizave laboratorike sipas përshkrimit të faturave nga data 25.02.2011 e deri me datën;13.04.2011,me kamatë ligjore duke llogaritur nga data e parashtrimit të propozimit për përmbarim deri në pagesën definitive të borxhit,të gjitha këto në afatin partitiv prej 7 (shtatë) ditëve,nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim pas pranimit të këtij aktgjykimi.

II.Refuzohet pjesa e kërkesëpadisë së paditësit për shumën prej;226,20 euro si e pabazuar.

III.Detryrohet pala e paditur ti paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore,palës paditëse në shumën e përgjithshme prej;\_\_\_\_\_euro,në afatin kohor prej 7 (shtatë) ditëve duke llogaritur nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim.

#### A r s y e t i m

Kreditori D. sh.p.k me seli në K. me datën;26.02.2013 ka parashtruar pranë kësaj gjykate propozimin e saj për përmbarim,lidhur me pagesën e borxhit në emër të kryerjes së analizave laboratorike sipas përshkrimit të faturave në shumën e përgjithshme prej;11.888,20 euro,me kamatë ligjore prej momentit ushtrimit të këtij propozimi e deri në pagesën definitive të borxhit të gjitha këto në afat kohor prej 15 ditëve nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim,ndaj palës së debitore K. E. sh.p.k me seli në P.,duke kërkuar në të njëjtën kohë nga kjo gjykatë aprovimin e tij si të bazuar,pas administrimit të të gjitha provave relevante të cilat gjinden në shkresat e lëndës.

Gjykata me rastin e pranimit të këtij propozimi ka lejuar të njëjtin me datën;22.03.2013 duke e njohtuar palën debitore lidhur me detyrimin e tij që rrjedh nga ky propozim.Mirëpo pala debitore në afatin ligjor konkretisht me datën;04.04.2013 ka parashtruar kundërshtimin ndaj këtij propozimi duke u arsyetuar në faktin se ndaj kreditorit nuk ka detyrim ashtu si thuhet në propozimin e tij për përmbaram,duke u aarsyetuar ne faktin se faturat e prezantuara nga pala kreditore nuk janë pranuar nga pala debitore,ndërsa pretendimi tjetër i palës debitore konsiston edhe në faktin se në kohën kur pretendon pala kreditore për këtë borxh të njëjtit i është pezulluar licenca nga Dogana e Kosovës,andaj bazuar në këto prova i ka propozuar gjykatës që të anuloh dhe shfuqizoj të gjitha veprimet e ndërmarra,duke e detyruar palën kreditore që ti paguaj shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Pas pranimit të kundërshtimit të palës debitore kjo gjykatë ka caktuar seancën përgatitore dhe pastaj edhe seancën e shqyrtimit kryesor duke shfuqizuar aktvendimin për lejimin e përmbarimit dhe duke vazhduar me zhvillimin e kontestit të rregullt civil bazuar në dispozitat e nenit 58 paragrafi 4 të LPK-së,në të cilat janë deklaruar edhe palët ndërgjyqëse duke i shprehur pretendimet e tyre lidhur me këtë çështje juridike.

### ***Pretendimet e palëve ndërgjyqëse***

I autorizuari i palës paditëse në seancën përgatitore,në seancat e mbajtura kryesore dhe në fjalën e tij përfundimtare ka kërkuar nga gjykata aprovimin e kërkesëpadisë së palës paditëse që konsiston në pagesën e borxhit në shumën e përgjithshme prej;11.888,20 euro,lidhur me kryerjen e analizave laboratorike sipas përshkrimit të faturave duke filluar nga ajo e datës;25.02.2011 deri me datën;13.04.2011 në shumën e përgjithshme prej 11.888,20 eurome kamatë ligjore duke llogaritur nga data e parashtrimit të propozimit për përmbaram e deri në pagesën definitive të borxhit .Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar dhe i ka specifikuar në fjalën e tij përfundimtare të hartuar me shkrim.

I autorizuari i palës së paditur si në përgjigjen në padi,seancën përgatitore,në seancat e mbajtura kryesore e poashtu edhe në fjalën e tij përfundimtare të hartuar me shkrim,ka mbetur pranë pohimit të tij lidhur me faktin se gjykata duhet të refuzoj kërkesëpadinë e palës paditëse pasiqë me asnjë provë nuk ka mundur të vërtetetoj bazën e saj,e cila konsiston në pretendimin e palës paditëse se e njëjta nuk ia ka dorëzuar asnjë faturë palës së paditur dhe të njëjtat nuk i ka nnëshkruar asnjë punëtor i saj,poashtu i njëjti ka pohuar se si pasojë e fajësisë së palës paditëse të paditurit i është pezulluar autorizimi me nr.PKD 2 dhe bazuar në të gjithë të cekuart më lartë i ka propozuar gjykatës refuzimin e kërkesëpadisë së paditëse,dhe duke e detyruar të njëjtin ti paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore palës së paditur në shumën e përgjithshme prej;564,00 euro.

Baza Juridike.

Objekt shqyrtimi i kësaj çështje juridike ka qenë pagesa e borxhit në shumën e përgjithshme prej;11.888,20 euro,si shumë e papaguar nga pala e paditur që rrjedh nga shërbimet e kryera në emër të kryerjes së analizave laboratorike për derivate të karburanteve sipas përshkrimit të faturave nga data 25.02.2011 e deri te fatura e datës;13.04.2011.

Provat e administruara si kontestuese dhe jokontestuese.

Me rastin e administrimit të të gjitha provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës gjykata ka bërë leximin e tyre duke filluar nga fatura e datës;25.02.2011 e deri te fatura e datës;13.04.2011,kundërshtimi i palës së paditur,shkresa e datës;05.04.2011 e lëshuar nga Dogana e Kosovës,letërdistribuiimi i lëshuar nga Dogana e Kosovës i datës;30.03.2011,vendimi i lëshuar nga MTI i datës;10.12.2010,parashtrësia e hartuar me shkrim nga pala e paditur e datës;30.12.2014,dhe vërejtja para padisë e hartuar nga pala paditëse.

Me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së palës paditëse gjykata paraprakisht është bazuar në faturat e nënshkruara nga pala e paditur duke filluar nga fatura e datës;25.02.2011 e deri te fatura e datës;13.04.2011 që vërtetohet se pala e paditur është në detyrim ndaj palës paditëse në shumën e përgjithshme prej;11.888,20 euro.Mirëpo me rastin e vërfikimit të secilës faturë veç e veç gjykata ka vërjetur se fatura me nr.01595 e datës;03.03.2011 në shumë prej;226.20 euro nuk është e nënshkruar nga pala e paditur andaj si të tillë e ka refuzuar pretendimin e palës paditëse lidhur me këtë shumë duke vendosur si në pikën dy të këtij aktgjykimi.

Ndërsa lidhur me pretendimet e palës së paditur që konsistojnë në deklarinin tij se si pasojë e fajësisë së palës paditëse i është pezulluar autorizimi nga Dogana e Kosovës,si pretendimi tjetër se faturat nuk janë të nënshkruara nga pala e paditur e as nga puntorët e saj,nuk janë prova të bazuara për gjykatën pasiqë i njëjti nuk i ka bërë të besueshme me asnjë provë valide për të vërtetuar të kundërtën e pretendimeve të palës paditëse,andaj edhe gjykata bazuar në nenin 506 të LPK-së të njëjtat i ka refuzuar si të pabazuara.

Gjykata me rastin e vendosjes lidhur me shqyrtimin,konstatimin dhe çmuarjen e të gjitha provave të prezantuara nga palët ndërgjyqëse është bazuar në nenin 8 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 të LPK-së,lidhur me afatin paritiv është bazuar në dispozitën e nenit 509 pika e të LPK-së,ndërsa lidhur me llogaritjen e kamatës ligjore është bazuar në dispozitën e nenit 277 të LMD-së.

Duke vendosur lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore gjykata është bazuar në dispozitat e nenit 452 paragrafi 1 të LPK-së,duke aprovuar shumën e përgjithshme prej;1.131,20 euro dhe atë si në vijim;për hartimin e propozimit për përmbarrim shumë prej;208,00 euro,për taksën gjyqësore shumë prej;56,00 euro,për marrjen e kopjes së aktgjykimit shumë prej;56,00 euro si dhe shumë prej;811,20 euro për përfaqësim në tri seanca të mbajtura (270,40 x3),ndërsa refuzohet pretendimi i palës paditëse për pagesën për dy seanca si e pabazuar (pasiqë të njëjtat nuk janë mbajtur).

Gjykata pas shtjellimit të të gjitha provave të kësaj çështje juridike ka vendosur si në dispozitivin e këtij aktgjykimi duke u bazuar në dispozitat e nenit 277, dhe nenit 262 të LMD-së, si dhe në nenin 506 dhe nenin 143 paragrafi 1 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË  
-Departamenti për Çështje Ekonomike-  
C.nr.160/2013 me datën;27.05.2015

Gjyqtari;  
Asllan Krasniqi

UDHËZIME JURIDIKE:Ndaj këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta e ankesës në afatin kohor prej 7 (shtatë) ditëve,duke llogaritur nga dita e pranimin të tij duke iu drejtuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj gjykate.